

## **RELACION**

### **PROJEKTI ELEKTRIK**

**OBJEKTI: " INVESTIME NË INFRASTRUKTURËN ARSIMORE NË  
KOPSHTE DHE SHKOLLA"**

**INVESTITORI: BASHKIA SARANDË**

**"C.E.C" group  
Lic. N.7038/2**

**Ing. \_\_\_\_\_**

## Hyrja

Relacioni jep informacion mbi zbatimin e punimeve te instalimeve te rrjetit elektrik, rrymave te dobeta si dhe te rrjetit te tokezimit, ku te gjitha projektimet jane realizuar sipas kerkesave te arkitekturës, funksionalitetit te objektit dhe normave dhe standardeve EU. Perfilimi i specifikimeve teknike ka si qellim te nenvizoje rolin e kontraktorit ne menyre qe te percaktohet ne menyren me te mire dhe materialin e duhur per zbatimin e punes.

- ) Projekti i sistemimit te prizave te fuqise
- ) Projektimi i shperndarjes se linjave elektrike

## Kategoria e objektit

Ne hartimin e projektit elektrik, per gjithe sistemin elektrik jane zbatuar standartet dhe normat e projektimit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ate european CE (DIN, BS, IEC, etj.). Ne projektin e sistemit elektrik te shperndarjes eshte zbatuar sistemi i cili garanton nje shkalle mbrojtje te larte.

## Te dhena te pergjithshme

Per te realizuar kete sistem jane marre parasysh ngarkesat elektrike te objektit per aparaturat qe duhen te instalohen ne te. Percaktimi i ngarkesave elektrike te vendosura eshte bere sipas projektit, ndersa i atyre te pritshme duhet te behet ne perputhje me rekomandimet qe jepen ne literature si edhe sipas pervojes se objekteve te tjera te ngjashme. Koeficenti i kerkeses ose te pajisjeve te njekohshmerise (faktori "gl" sipas normave VDE) jane marre nga vlerat e meposhtme orientuese:

- ) Per sistemin e ndricimit elektrik----- 1
- ) Priza e fuqise----- 0.1-0.2

## Mates i energjise elektrike

Matja e energjise elektrike hyne ne grumbullimin e matjeve me rendesi dhe me te shumta behen ne prodhim, mbartjen, distribuimin dhe harxhimin e energjise elektrik. Aparati qe mat energjine elektrike quhet njehsor induktiv elektrik. Njehsoret elektrik mund te ndertohen:

- ) Per rryme te vazhduar
- ) Per rryme alternative

Materialet jane te sigurta dhe kur jane nen ngarkese, nen tension apo nen veprimin e lidhjes se shkurter apo avarive te tjera qe mund te ndodhin ne sistem, ato sigurojne dhe punojne ne kushte optimale. Te gjitha materialet e perdorura per prodhimin e matesit te energjise elektrike jane ten je cilesie te mire dhe te pershtatshme per pune dhe kushte specifike.



## Automat mbrojtës

Pajisjet mbrojtëse duhet te jene automate sipas normes [CEI 60898](#) dhe [CEI 60947-2](#). Keta automate mbrojnë pajisjet dhe sigurojnë nje veprim te shpejte nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurtra. Keta automate duhet te lidhen para pajisjeve fundore dhe qarqeve te cilat nuk kane prezence direkte te personelit.



Per personelin e kualifikuar, per kontrollin dhe matjen e sakte te konsumit te energjise dhe per vrojtimin e parametrave specifike si koeficenti i fuqise te perdoren pajisje sipas normes [IEC 62053-21](#). Keto pajisje sigurojnë nje cilesi te matjes se energjise aktive ne shkallen 1 dhe te energjise reaktive ne shkalle 2.

## **Norma te rrjetit shperndares te grupeve**

- ) Te gjithe grupet e ndricimit dhe prizave do te mbrohen me automate magnetotermike dhe shkeputes diferencial 30mA.
- ) Seksioni perçjellsave te linjave te ndricimit nuk do te jetë me i vogel se seksioni  $1,5\text{mm}^2$  prej bakri. Automatet magnetotermike do te jene 10 A me fuqi maksimale te cdo grapi monofazor jo me shume se 1500W.
- ) Prizat per aparaturat e ndryshme elektrike me fuqi me te vogel ose te barabarte me 2600W, do te jene me seksion  $2,5\text{mm}^2$ /baker kurse mbrojtja perkatese 16A.

## **Kanalet dhe aksesoret**

- Instalimet elektrike do te behen ne dy menyra:

- ) Nen dysheme te futur ne tuba PVC fleksibel
  - ) Ne tavan te mbuluar me kanaline

- Aksesoret e instalimeve elektrike:

- ) Tubat PVC te dimensioneve te ndryshme ne varesi te dimensionit dhe te vendit ku do futen kabllot.
- ) Kanaline normale per te fshehur kabllot ne tavan po dhe per gjate dyshemese
- ) Kutite per fiksimin e prizave dhe celesave

E rendesishme eshte qe lidhja e telave /kabllove brenda ne kutine shperndarese te realizohet me ane te klemeve bashkuese/kepuçave lidhese dhe jo me nastro.

- Impianti elektrik duhet te zbatohet sipas:

- ) Permasave, markes, karakteristikave, dhe cilesise se materialit te treguar ne projektet e hartuara
  - ) Udhezimeve te D.R gjate kryerjes se puneve
  - ) Ndjeke dhe zbatim te ligjeve ne fuqi

Materialet dhe aparatet qe duhet te përdoren ne ndertimin e impiantit duhet te kene te gjitha cilesite e fortisise, kohezgjatjes, izolimit dhe te funksionimit te mire; dhe duhet gjithashtu te jene te tilla qe ti rezistojne veprimeve mekanike, gerryese, termike dhe lageshtires per ato qe duhet te jene ne kontakt me te gjate punes. Gjithashtu, janë nen perqegjesine e sipermarresit montimet dhe cmontimet përkatëse te pjesëve te instalimit per realizimin e provave dhe te verifikimeve.

- Impianti, sipas udhezimeve ne projekt, do te jetë i perbërë kryesisht nga:

- tub termoplastik fleksibel me diameter mm 16, 20, 32 etj., vetshuhes, i vendosur në nepër brenda kanaleve te parapergatitur, duke perfshire veprat muraturës, skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim e paisje tjeter;

## **Karakteristikat teknike te kabllove dhe perçjellesave elektrike te fuqise**

Te gjitha llojet e kabllove qe do te perdoren ne project duhet te perputhen me specifikimet teknike, kategoria FG16R16 / FG16OR16 0,6/1 kV;. Kabllo rixhid kontrolli per instalimet qe nuk perhapin zjarr me veti te ulet korroduese. G16 i izoluar me cilesi HEPR. CPR UE 305/11.

- ) F - Klasa e perçjellesave



- ) G16 – Gome e rende eliten-propilen tipi G16
- ) Kabllo rrethore shume dejesh (fije)
- ) R16 - PVC tipi R16,

) Ndertimi:

- ) Percjelles i holle bakri, klasa 5.
- ) Gome rixhid EPM , cilesia G16
- ) Kompleksi termoplastik, rezistent ndaj zjarrit, jo absorbues i ujit.
- ) Anti-korrodues PVC me kualitet R16, fire retardant, with reduced gas emission

) Referenca e standartit:

- ) CEI 20-13; IEC 60502-1
- ) CEI UNEL 35318-35322-35016
- ) EN 50575:2014
- ) EN 50575/A1:2016

) Te pergjithshme:

- ) Percjelles fleksibel bakri klasa 5-te.
- ) Izolim me perzierje elastomerike (G16 quality).
- ) Pa fije dhe pa mbushje higroskopike.
- ) Veshje e jashtme tip PVC R16 transparente.

) Karakteristikat teknike:

- ) Tensioni nominal U0: 0.6 kV(AC) 1.8 kV(DC)
- ) Tensioni nominal U : 1 kV(AC), 1.8 kV(DC)
- ) Tensioni I testuar : 4 kV
- ) Tensioni maksimal Um : 1.2 kV(AC); 1.8 kV(DC)
- ) Temperatura maksimale funksionale: 90°C
- ) Temperatura maksimale e qarkut te shkurter per sektion deri ne 240mm<sup>2</sup>: 250
- ) Temperatura maksimale e qarkut te shkurtërprt sektion mbi 240mm<sup>2</sup>: 240
- ) Temperatura minimale funksionale (pa goditjet mekanike): -15°C
- ) Temperatura minimale e instalimit dhe perdonimit: 0°C

) Karakteristika te perbashketa:

Per sistemin e energjise elektrike ne ndertime dhe ndertime te tjera inxhinierike civile, ne menyre te reduktimit te zjarrit dhe tymi, ne perputhje me CPR. Fuqia dhe kontrolli perdonin aplikime te jashtme dhe te brendshme madje edhe me lageshtire. Te pershtatshme per instalime te jashtme te perershme, ne tubo ose kanale, armature, struktura metalike, tela ajror, dhe per instalime direkte ose indirekte nentokesore. Nuk janë te ndikuara per lidhjet me panelet fotovoltaik. Fuqia dhe kontrolli perdonin aplikime, ne ne lageshtire AD6.

) Perdonimi

- ) Rrezja minimale ne perkulje per diameter kablli D (ne mm):
- ) Kabllo fuqie fleksibel , klasa 5= 4 D;

- ) Kabllo fleksibel kontrolli ,klasa 5 = 6 D;
- ) Sforcimi maksimal ne terheqje: 50N/mm<sup>2</sup>.

) Ngjyrat e dejve (fijeve)

- ) Deje e vetme : e zeze
- ) Dy deje: blu-kafe
- ) Tre deje: kafe-e zeze-gri (ose blu-kafe-Y/G)
- ) Kater deje: blu-kafe-e zeze-gri (ose Y/G ne vend te blu)
- ) Pese deje: Y/G-blu-kafe-e zeze-gri (ose te zeze ne vend te Y/G)
- ) Shume deje: e zeze me numra

) [Karakteristikat e kabllit FTG10OM1](#)



Specifikimet teknike per kabullin FTG10(O)M1:

- |                          |  |
|--------------------------|--|
| ) Izolimi:               | <b>gome, tipi G.10</b>                             |
| ) Veshje e jashtme:      | <b>blu (RAL 5012) komponim pa halogen, tipi M1</b> |
| ) Tensioni normal:       | <b>0.6/1kV</b>                                     |
| ) Shkalla e teperatures: | <b>-25°C deri ne +90°C</b>                         |
| ) Percjellesi:           | <b>percjelles i kuq bakri fleksibel Cl.5</b>       |

Sipas standartit:

- ) EN 50266 / IEC 60332-3-24 / CEI 20-22III
- ) EN 50267-2-1 / IEC 60754-1 / DIN VDE 0482 part.267-2-1
- ) IEC 60331 / EN 50200

Ngarkesa e fuqise e llogaritur per kabllot me lart duhet te respekoje:

- ) Per kabllot 1-6mm<sup>2</sup> dendesia mesatare e energjise 4A / mm<sup>2</sup>
- ) Dendesia mesatare e kabllave 6-16mm<sup>2</sup> 2-4Amm<sup>2</sup>
- ) Per kabllot > 16mm<sup>2</sup> dendesia mesatare 1-2Amm<sup>2</sup>

### [Sekzioni i percjellesit te Nulit](#)

Percjellesat e nulit duhet të kenë seksion më të vogël se seksioni i fazave. Për kabllot me seksion > 16 mm<sup>2</sup>, seksioni i nulit sipas CEI mund të reduktohet deri në gjysmen e seksionit të fazave. Sipas VDE seksioni i nulit duhet gjithmonë (pavarësisht nga seksioni i fazave) i njëlojte me atë të fazave.

### **Sistemi i prizave te fuqise**

Per rrjetin e prizave te fuqise, prizat jane vendosur ne projekt mbeshtetur mbi planimetrine dhe funksionalitetin e saj.

Te gjitha prizat jane 2P+T, 2 module 230V, 16A, me tokëzim. Instalimi nga kuadrot e shperndarjes deri tek kutia shperndarese te prizave do te behet me percjelels S=3x(1x4)mm<sup>2</sup> te futur ne tubo PVC fleksibel d=25 mm ne ambientet ku kalojne ne mure.

Instalimet elektrike te fuqise dhe sinjalizimit qe kalojne ne dysheme behen me tub te rende, kurse ato qe kalojne ne mure dhe tavane jane te serise se lehte. Tubat PVC fleksibel elektrik duhet te jene te gjithe te pa djegshem. Projekti parashikon mbrojtjen diferenciale me rele diferenciale 30mA.  $R_t < 3$  dhe mbrojtjen nga LSH me automat magneto-termik.

Instalimi i elementeve do te behet si me poshte:

- Lartesia e kuadrit do te jete 170cm nga dyshemeja.
- Lartesia e çelsave do te jete 110 cm nga dyshemeja.
- Laresia e kutive shperndarese 25 cm nga dyshemeja.
- Lartesite e prizave do te jete 40cm nga dyshemeja.



#### Karakteristikat teknike të kutive të shpërndarjes:

- Në materiale termoplastike vetë-shuarja dhe rezistente ndaj nxehtësisë jonormale dhe zjarrit deri në  $650^{\circ}\text{C}$  (test me tela shkëlqim) në përputhje me standardin IEC 60695-2-11
- Kapak në RAL 9016 me vida me vida të përfshira në furnizimin FLC09915
- Temperatura e punes nga  $-5^{\circ}\text{C}$  deri  $+60^{\circ}\text{C}$
- Aksesorët e kablove dhe kutitë e kryqëzimit të bëra në përputhje me standarde CEI EN 60670-1 dhe CEI EN 60670-22
- Kuti e re e zgjeruar për 3 module me pajisje të reja (mbulesa e llaçit, spacer, ndarës)



| Code   | Dimensions (mm)<br>WxLxD | Extrusion<br>Nr. items | Code   | Dimensions (mm)<br>WxLxD | Extrusion<br>Nr. items |
|--------|--------------------------|------------------------|--------|--------------------------|------------------------|
| 00 070 | 90x30x45                 | 1/105                  | 00 075 | 190x152x70               | 1/19                   |
| 00 071 | 120x100x50               | 1/72                   | 00 076 | 294x152x70               | 1/15                   |
| 00 072 | 120x100x70               | 1/40                   | 00 077 | 392x152x70               | 1/11                   |
| 00 073 | 160x100x70               | 1/42                   | 00 078 | 480x160x70               | 1/10                   |
| 00 074 | 160x180x70               | 1/32                   |        |                          |                        |

The separate code 00 080 can be inserted for all art. codes.

#### **Sistemi i ndricimit**

Pavaresisht ambientit i cili do te ndricohet llogaritja e ndricimit eshte bere sipas norms UNI EN 12464 duke prijuar nje siperfaqe uniforme te ndricuar mire ne cdo pjese te saj dhe te qete per punen e personelit dhe te gjithe njerezve. Ndricimi shtet projektuar sipas tipologjise se ambientit duke plotesuar kushtet dhe normat mbi llojin e ndricimit, niveleve dhe rrezikshmerise se instalimit te tij.